4.2.1 Skema e aplikimit Harta bazë mbulim

Kodlistat
<i>VleratELlojitTëTeknologjisë</i>

4.2.1.1 Vlerat e llojit të teknologjisë

-- **Emri** --

Vlerat e llojit të teknologjisë

-- **Përkufizimi** --

Teknologjia e përdorur për krijimin e hartës bazë.

-- **Vlerat** --

Tabela më poshtë përfshin vlerat e rekomanduara që mund të përdoren nga ofruesit e të dhënave. Para krijimit të kushteve të reja, duhet të kontrollohet nëse ndonjëra prej tyre mund të përdoret.

Kodlistë
-- Emri -- Fotogrametri/Remote Sensing
-- Përkufizimi -- Metoda e matjes së të dhënave me anë të procesit të fotografimit ajror.
-- Emri -- Gjeneralizimi
-- Përkufizimi -- Metoda e matjes së të dhënave me anë të procesit të gjeneralizimit.
-- Emri -- Kombinuar

**Kodlistë****-- Përkufizimi --**

Kombinimi i disa metodave teknologjike (p.sh., kombinimi i metodës së fotogrametrisë dhe rilevimit).

-- Emri --

Takiometri/rilevimi

-- Përkufizimi --

Metoda me rilevim e marrjes së të dhënave në terren.

-- Emri --

Të tjera.

-- Përkufizimi --

Llojet të tjera të teknologjisë së përdorur.

4.3 Aneksi C – Simbologjia e hartës bazë

Një ndër aspektet kryesore të paraqitjes vizive të hartës bazë është krijimi dhe ndërtimi i një modeli klasifikimi të simbologjisë së elementeve hartografike. Për këtë arsye, ASIG-u, si autoritet publik përgjegjës për temën “Hartës bazë”, harton “Manualin hartografik” për prodhimin e hartës bazë. Ky manual përcakton rregullat dhe mënyrën e përdorimit të simboleve, teksteve dhe klasifikimin e ngjyrave në hartën bazë. Manuali hartohet dhe publikohet në faqen zyrtare të ASIG-ut, brenda 3 muajve nga miratimi i këtij dokumenti.

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 228, datë 20.11.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM
PËR FITIMIN, HEQJEN DORË DHE
RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE,
FORMËN DHE MËNYRËN E
PLOTËSIMIT TË KËRKESËS, TË
PROCEDURËS PËR KRYERJEN E
VERIFIKIMEVE PRANË
INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE, SI
DHE TË DOKUMENTACIONIT PËR
SHTYRJEN E AFATIT PËR KRYERJEN
E BETIMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar,

UDHËZOJMË:**I. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR
FITIMIN E SHTETËSISË ME ORIGJINË**

1. Shtetësia shqiptare fitohet nga i huaji, të paralindurit e të cilit kanë origjinë shqiptare, me kusht që të provohet lidhja familjare në vijë të drejtë, deri në tri shkallë, e kërkuesit me të paralindurit.

1.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje/ekstrakt lindjeje/personale;

c) certifikatë familjare (për vendet që nuk e lëshojnë, të shoqërohet me dokument zyrtar justifikues);

ç) certifikatë apo çdo dokument tjetër mbi bazën e të cilit vërtetohet origjina shqiptare e kërkuesit, në vijë të drejtë, deri në tri shkallë, qoftë edhe nga njëri prind;

d) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të shtetësisë tjetër të aplikuesit dhe/ose të shtetit të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm mbi gjashtë muaj;

dh) mandatpagesa.

1.2 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

b) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike.

**II. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR
FITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE ME
NATYRALIZIM**

1. Shtetësia shqiptare fitohet me natyralizim nga i huaji mbi 18 vjeç me qëndrim të rregullt në Republikën e Shqipërisë.

1.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:



a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes/personale;

c) dokument i cili vërteton njohuri të gjuhës shqipe në nivelin A2 të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor (bëjnë përjashtim vetëm për shtetasit e huaj në shtetet e të cilëve gjuha shqipe është gjuhë zyrtare);

ç) dokument i cili vërteton se ka kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë (bëjnë përjashtim vetëm për shtetasit e huaj në shtetet e të cilëve gjuha shqipe është gjuhë zyrtare);

d) akti i pronësisë së banesës/kontrata e marrjes me qira të banesës/deklaratë noteriale, lidhur me banimin ose çdo dokument tjetër që vërteton akomodimin e shtetasit në Republikën e Shqipërisë (kopje e njëzuar me origjinalin);

dh) dokument që vërteton disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: vërtetime zyrtare të ardhurash/kontratë pune për të punësuarit dhe vërtetim kontributesh/ vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (kopje e njëzuar me origjinalin);

e) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të shtetësisë tjetër të aplikuesit dhe/ose të shtetit të tretë ku kërkuksi ka pasur qëndrim të ligjshëm mbi gjashtë muaj;

ë) mandatpagesa.

1.2 Dokumentacioni i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) leje e përhershme qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë;

b) vërtetim nga autoriteti i kufirit dhe migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;

ç) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë;

d) vërtetim i gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

2. Personi pa shtetësi mund të aplikojë për fitimin e shtetësisë shqiptare me natyralizim.

2.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të vet, të shtetit të tretë ku kërkuksi ka pasur qëndrim të ligjshëm mbi gjashtë muaj;

c) mandatpagesa.

2.2 Dokumentacioni i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) leje e përhershme qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë;

b) vërtetim nga autoriteti i kufirit dhe migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;

ç) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë;

d) vërtetim i gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

3. I huaji mbi 18 vjeç, i martuar me shtetas shqiptar mund të aplikojë për fitimin e shtetësisë shqiptare, me natyralizim.

3.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes/personale;

c) certifikatë martese;

ç) akti i pronësisë së banesës/kontrata e marrjes me qira të banesës/deklaratë noteriale lidhur me banimin ose çdo dokument tjetër që vërteton akomodimin e shtetasit në Republikën e Shqipërisë (kopje e njëzuar me origjinalin);

d) dokument që vërteton disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: vërtetime zyrtare të ardhurash/kontratë pune për të punësuarit dhe vërtetim kontributesh/ vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (kopje e njëzuar me origjinalin);

dh) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të origjinës dhe/ose



të një shteti të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

e) mandatpagesa.

3.2 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) lejeqëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kriterëve të ligjit për shtetësinë (të paktën për një vit, gjatë të gjithë periudhës së martesës);

b) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;

c) mendimi me shkrim i komisarit të policisë vendore, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë;

ç) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

4. I huaji mbi 18 vjeç, fëmija i mitur i të cilit ka shtetësi shqiptare, mund të aplikojë për fitimin e shtetësisë me natyralizim.

4.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes/personale;

c) certifikatë familjare (për vendet që nuk e lëshojnë, të shoqërohet me dokument zyrtar justifikues);

ç) certifikatë lindjeje të fëmijës me shtetësi shqiptare;

d) akti i pronësisë së banesës/kontrata e marrjes me qira të banesës/deklaratë noteriale, lidhur me banimin, ose çdo dokument tjetër që vërteton akomodimin e shtetasit në Republikën e Shqipërisë (kopje e njëzuar me origjinalin);

dh) dokument që vërteton disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: vërtetime zyrtare të ardhurash/kontratë pune për të punësuarit dhe vërtetim kontributesh/ vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (kopje e njëzuar me origjinalin);

e) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës dhe/ose të një shteti të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

ë) mandatpagesa.

4.2 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) lejeqëndrimi të vlefshme në momentin e aplikimit, e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kriterëve të ligjit “Për shtetësinë”, i ndryshuar;

b) vërtetim nga autoriteti i kufirit dhe migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 3 (tre) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;

ç) mendimi me shkrim i formuluar nga komisarati i policisë vendore ku aplikuesi ka banimin, i cili duhet të përmbajë gjeneralitetet e aplikuesit, adresën e saktë të vendbanimit dhe të sqarojë sjelljen e aplikuesit gjatë kohës së qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, precedentin e tij penal (nëse ka);

d) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

5. Fëmija i mitur, i dy prindërve që kanë fituar shtetësinë shqiptare me natyralizim, mund të aplikojë për fitimin e shtetësisë me natyralizim, duke dorëzuar dokumentet e mëposhtme:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë nga të dy prindërit ku shprehet dhe pëlqimi i fëmijës kur është në moshën 14–18 vjeç, drejtuar strukturës vendore përgjegjëse të Policisë së Shtetit të vendbanimit të tij;

b) dokument i cili vërteton njohuri të gjuhës shqipe në nivelin A2 të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

c) dokument i cili vërteton se ka kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç, lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë;

ç) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes/personale;

d) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës dhe/ose të një shteti të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj, vetëm për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

dh) deklarata noteriale, ku shprehet pëlqimi i prindërve/kujdestarit ligjor lidhur me fitimin e shtetësisë shqiptare për fëmijën e mitur.

e) mandatpagesa.

5.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:



a) dokument zyrtar i lëshuar nga institucionet shqiptare, ku të evidentohet shtetësia shqiptare e fituar nga të dy prindërit;

b) lejeqëndrimi të vlefshme, e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

c) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë, vetëm për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

ç) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

d) mendimi me shkrim i komisarit të policisë vendore, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç.

6. Fëmija i mitur i një prindi që ka fituar shtetësinë shqiptare me natyralizim, mund të aplikojë për fitimin e shtetësisë me natyralizim, duke dorëzuar dokumentet e mëposhtme:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë nga të dy prindërit ose nga njëri prej prindërve (në këtë rast, prindi tjetër duhet të japë pëlqimin me shkrim) dhe pëlqimi i fëmijës, kur është në moshën 14–18 vjeç, drejtuar strukturës vendore përgjegjëse të Policisë së Shtetit të vendbanimit të tij;

b) dokument i cili vërteton njohuri të gjuhës shqipe në nivelin A2 të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

c) dokument i cili vërteton se ka kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç, lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë;

ç) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes/personale;

d) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës dhe/ose të një shteti të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj, vetëm për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

dh) deklaratë noteriale, ku shprehet pëlqimi i prindërve/kujdestarit ligjor lidhur me fitimin e shtetësisë shqiptare për fëmijën e mitur;

e) mandatpagesa.

6.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) dokument zyrtar i lëshuar nga institucionet shqiptare, ku të evidentohet shtetësia shqiptare e fituar nga njëri prind;

b) lejeqëndrimi të vlefshme në momentin e aplikimit, e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

c) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë, vetëm për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

ç) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

d) mendimi me shkrim i komisarit të policisë vendore, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç.

III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË ME BIRËSIM:

1. Në rast birësimi nga dy bashkëshortë me shtetësi shqiptare të një fëmije me shtetësi tjetër ose pa shtetësi, fëmija fiton shtetësinë shqiptare. Fëmija i birësuar e fiton shtetësinë shqiptare edhe kur vetëm njëri prej bashkëshortëve është shtetas shqiptar, si dhe në çdo rast tjetër kur fëmija rrezikon të mbetet pa shtetësi si rezultat i birësimit.

1.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë e bashkëshortëve drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) akti i lindjes së fëmijës/certifikatë nga akti i lindjes;

c) dokumenti, akti administrativ, mbi bazën e të cilit është vendosur për birësimin e fëmijës;

ç) deklaratë noteriale, ku shprehet pëlqimi i prindërve/kujdestarit ligjor lidhur me fitimin e shtetësisë shqiptare për fëmijën e mitur;

d) mandatpagesa.

IV. DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR FITIMIN E SHTETËSISË NGA REFUGJATËT APO PERSONA NË MBROJTJE PLOTË-SUESE

1. Shtetësia shqiptare fitohet nga refugjati, apo personi në mbrojtje plotësuese mbi 18 vjeç, që ka paraqitur kërkesë, duke plotësuar dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) dokument i cili vërteton se zotëron njohuri të gjuhës shqipe, të folur dhe të shkruar, njohuritë bazë të historisë e të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor;



c) akti i pronësisë së banesës/kontrata e marrjes me qira të banesës/deklaratë noteriale, lidhur me banimin, ose çdo dokument tjetër që vërteton akomodimin e shtetasit në Republikën e Shqipërisë (kopje e njësuar me origjinalin);

ç) dokument që vërteton disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: vërtetime zyrtare të ardhurash/kontratë pune për të punësuarit dhe vërtetim kontributesh/ vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (kopje e njësuar me origjinalin);

d) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

dh) Vendimi për njohjen e statusit (lëshuar nga autoriteti përgjegjës për Azilin, kopje e njësuar me origjinalin);

e) mandatpagesa.

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) leje qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kriterëve të ligjit për shtetësinë;

b) vërtetim nga autoriteti i kufirit dhe migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë nga data e marrjes së statusit;

c) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;

ç) vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

d) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë.

V. DOKUMENTE QË KËRKOHEN PËR HEQJEN DORË NGA SHTETËSIA SHQIPTARE

1. Për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, të cilët kërkojnë heqjen e shtetësisë shqiptare, kërkohen këto dokumente:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) premtim nga autoriteti kompetent i vendit të shtetësisë tjetër ose dokument, ku konfirmohet shtetësia e një vendi tjetër;

c) certifikatë lindjeje ose personale e aplikuesit;

ç) certifikatë familjare e aplikuesit;

d) vërtetim i lëshuar nga gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;

dh) vërtetim i lëshuar nga Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;

e) vërtetim i lëshuar nga zyra e përmbarimit, nëse ka detyrime ndaj personave fizikë dhe juridikë, privatë apo shtetërorë;

ë) vërtetim i lëshuar nga zyra e përmbarimit, nëse ka likuiduar të gjitha detyrimet financiare për bashkëshortin/bashkëshorten/fëmijën apo personat nën kujdestari;

f) dokument që vërteton rezidencën, vendbanimin e tij në shtetin nga i cili i është premtuar shtetësia tjetër ose në vendin e shtetësisë tjetër;

g) mandatpagesa.

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

b) mendimi me shkrim i formuluar nga komisarati i policisë vendore ku aplikuesi ka vendbanimin, i cili duhet të përmbajë gjeneralitetet e aplikuesit, adresën e saktë të vendbanimit dhe të sqarojë sjelljen e aplikuesit gjatë kohës së tij në territorin e Republikës së Shqipërisë, precedentin e tij penal (nëse ka);

2. Për fëmijët e moshës 0–14 vjeç të paraqitet:

a) kërkesë e prindërve/kujdestarit ligjor, drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje/personale e fëmijës me shtetësi shqiptare;

c) deklarata noteriale e të dy prindërve/kujdestarit ligjor (ose vetëm e njërit prej prindërve, sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së tyre (kur aplikohet për fëmijët e tyre deri në moshën 18 vjeç, të cilët duhet të kenë premtim shtetësie, ose shtetësi tjetër));

ç) mandatpagesa.

3. Për fëmijët e moshës 14–18 vjeç, kërkohen këto dokumente:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) dokumentacioni sipas përcaktimeve të pikës 1, të paragrafit V, të këtij udhëzimi;

c) deklarata noteriale e të dy prindërve (ose vetëm e njërit prej prindërve apo kujdestarit ligjor sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020,



“Për shtetësinë”, i ndryshuar), ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare i fëmijës së tyre.

VI. DOKUMENTE QË KËRKOHEN PËR RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE

1. Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe nuk ka fituar shtetësi tjetër, për rifitim të shtetësisë shqiptare depoziton:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje nga akti/personale dhe familjare;

c) deklaratë noteriale nga çdo aplikant mbi moshën 14 vjeç, për faktin e aplikimit ose jo për të fituar shtetësi tjetër, si dhe nëse aktualisht është person pa shtetësi;

ç) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të tretë dhe/ose të shtetit ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

d) vërtetim banimi i lëshuar nga njësia administrative përkatëse;

dh) dokument i cili vërteton heqjen e shtetësisë shqiptare;

e) certifikatë lindjeje/vdekje e prindërve të aplikuesit;

ë) mandatpagesa.

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore, i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

b) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike.

2. Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe ka fituar një shtetësi tjetër, për rifitim të shtetësisë shqiptare depoziton:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje nga akti/personale (marrë në Republikën e Shqipërisë dhe në vendin e shtetësisë së fituar);

c) certifikatë familjare (marrë në Republikën e Shqipërisë dhe në vendin e shtetësisë së fituar);

ç) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të shtetësisë tjetër që ka aplikanti dhe/ose të shtetit ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

d) dokumentin i cili vërteton heqjen dorë nga shtetësia shqiptare;

dh) dokumentin i cili vërteton shtetësinë e huaj;

e) mandatpagesa.

2.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

b) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;

VII. PËRCAKTIMI I RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM, FORMËN DHE MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË KËRKESËS PËR HEQJEN DORË DHE RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE, PËR PERSONAT QË BANOJNË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Aplikimi për rifitimin dhe heqjen dore nga shtetësia shqiptare për shtetasit shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet pranë misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Shqipërisë, ku ka vendbanim aplikuesi, ose në përfaqësinë diplomatike, e cila mbulon shtetin ku ka vendbanim aplikuesi, në rastet kur nuk ka përfaqësi diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë, të hapur aty.

VIII. DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR HEQJE DORË TË SHTETËSISË SHQIPTARE

1. Për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, të cilët kërkojnë heqjen e shtetësisë shqiptare, kërkohen këto dokumente:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) premtimi nga autoriteti kompetent i vendit të shtetësisë tjetër ose dokument origjinal, ku konfirmohet shtetësia e një vendi tjetër. Në rast se personi ka fituar shtetësi tjetër, duhet të paraqesë kopje të njëzuar të mjetit të identifikimit, që e vërteton atë;

c) certifikatë lindjeje ose personale e aplikuesit;

ç) certifikatë familjare e aplikuesit;

d) vërtetim i lëshuar nga gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm

dh) vërtetim i lëshuar nga Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;

e) vërtetim i lëshuar nga zyra e përmbarimit, nëse ka detyrime ndaj personave fizikë dhe juridikë, privatë apo shtetërorë;



ë) vërtetim i lëshuar nga zyra e përmbarimit, nëse ka likuiduar të gjitha detyrimet financiare për bashkëshortin/bashkëshorten/fëmijën apo personat nën kujdestari.

f) dokument që vërteton rezidencën, vendbanimin e tij në shtetin nga i cili i është premtuar shtetësia tjetër ose në vendin e shtetësisë tjetër;

g) mandatpagesa.

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) certifikatë lindjeje ose personale e aplikuesit;

b) certifikatë familjare e aplikuesit;

c) vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

2. Për fëmijët 0–14 vjeç kërkohen këto dokumente:

a) kërkesa e prindërve ose kujdestarit/eve ligjorë për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje ose personale e fëmijës me shtetësi shqiptare;

c) deklaratë noteriale e të dy prindërve (ose vetëm njërit prej prindërve, sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së tyre (kur aplikohet për fëmijët e tyre deri në moshën 18 vjeç, të cilët duhet të kenë premtim shtetësie të shtetit të huaj));

ç) mandatpagesa.

3. Për fëmijët 14–18 vjeç kërkohen këto dokumente:

a) kërkesë individuale për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) dokumentacioni sipas përcaktimeve të pikës 1, të paragrafit II, të këtij udhëzimi, për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare;

c) deklaratë noteriale e të dy prindërve (ose vetëm njërit prej prindërve, sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së tyre).

IX. DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE

1. Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe nuk ka fituar shtetësi tjetër, për rifitim të shtetësisë shqiptare depoziton:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje nga akti/personale dhe familjare;

c) deklaratë noteriale nga çdo aplikant mbi moshën 14 vjeç, për faktin e aplikimit ose jo për të fituar shtetësi tjetër, si dhe nëse aktualisht është person pa shtetësi;

ç) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të tretë dhe/ose të shtetit ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

d) vërtetim banimi i lëshuar nga njësia administrative përkatëse;

dh) dokument i cili vërteton heqjen e shtetësisë shqiptare (dekreti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë ose certifikatë aktuale personale ku shënohet numri dhe data e dekretit të heqjes dorë nga shtetësia);

e) certifikatë lindjeje/vdekje e prindërve të aplikuesit;

ë) mandatpagesa.

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) certifikatë lindjeje nga akti/personale dhe familjare;

b) vërtetim banimi i lëshuar nga njësia administrative përkatëse;

c) certifikatë lindjeje/vdekjeje e prindërve të aplikuesit;

d) vërtetim i gjendjes gjyqësore, i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

e) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;

f) mendimi me shkrim i formuluar nga komisarati i policisë vendore ku aplikuesi ka banimin, i cili duhet të përmbajë gjeneralitetet e aplikuesit, adresën e saktë të vendbanimit dhe të sqarojë sjelljen e aplikuesit gjatë kohës së tij në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe ka fituar një shtetësi tjetër, për rifitim të shtetësisë shqiptare depoziton:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje nga akti/personale (marrë në Republikën e Shqipërisë dhe në vendin e shtetësisë së huaj);

c) certifikatë familjare (marrë në Republikën e Shqipërisë dhe në vendin e shtetësisë së huaj);

ç) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të shtetësisë tjetër që



ka aplikanti dhe/ose të shtetit ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

d) dokumentin i cili vërteton heqjen dorë nga shtetësia shqiptare (dekreti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë ose certifikatë aktuale personale ku shënohet numri dhe data e dekretit të heqjes dorë nga shtetësia);

dh) dokumentin i cili vërteton shtetësinë e huaj (pasaportë, kartë identiteti, certifikatë natyralizimi/personale ose vërtetim nga bashkia/ komuna);

e) mandatpagesa.

2.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) certifikatë lindjeje nga akti/personale në Republikën e Shqipërisë;

b) certifikatë familjare në Republikën e Shqipërisë;

c) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

d) mendimi me shkrim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që aplikuesi nuk përbën cenim për rendin dhe sigurinë publike;

e) mendimi me shkrim i formuluar nga komisarati i policisë vendore ku aplikuesi ka banimin, i cili duhet të përmbajë gjeneralitetet e aplikuesit, adresën e saktë të vendbanimit dhe të sqarojë sjelljen e aplikuesit gjatë kohës së tij në territorin e Republikës së Shqipërisë.

X. FORMA DHE MËNYRA E PLOTËSIMIT TË KËRKESËS

1. Aplikimi për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare bëhet përmes sistemit elektronik të sigurt *online*, duke plotësuar të dhënat e kërkuara dhe duke ngarkuar *online* kërkesën individuale.

2. Aplikimi për heqje dorë nga shtetësia shqiptare në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore mund të kryhet nga vetë aplikuesi, nga prindi për fëmijën deri në moshën 18 vjeç, ndërsa për aplikimet brenda Republikës së Shqipërisë edhe nga përfaqësuesi me prokurë të posaçme.

3. Kërkesa individuale për fitimin e shtetësisë shqiptare për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, duhet të përmbajë: emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, adresën e përhershme, periudhën e ardhjes në Shqipëri, profesionin e ushtruar në shtetin e huaj dhe në Shqipëri. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër, firmë.

4. Kërkesa individuale për rifitimin e shtetësisë shqiptare për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, duhet të

përmbajë: emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, adresën e përhershme, si dhe numrin dhe datën e dekretit me të cilin ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare. Gjithashtu, në kërkesë duhet të bëhet e qartë nëse kërkuesi ka fituar apo jo një shtetësi tjetër. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër, firmë.

5. Kërkesa individuale për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, duhet të përmbajë: emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, adresën e përhershme. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër, firmë.

6. Aplikimi për fitimin e shtetësisë shqiptare nga shtetas të huaj, bëhet nga vetë kërkuesi (për rastet e fitimit të shtetësisë shqiptare nuk aplikohet nga përfaqësuesi i tij me prokurë të posaçme). Aplikimi për shtetësinë shqiptare është individual, përveç të miturve nën moshën 14 vjeç, për të cilët shprehen prindërit apo kujdestari ligjor i tyre.

7. Dokumentet për shtetësinë shqiptare pranohen kur janë në harmoni të plotë me njëritjetrin, pa gabime e pa korrigjime në përmbajtjen e tyre. Dokumentet e lëshuara nga shteti shqiptar, duhet të mos kapërcejnë gjashtë muajt e fundit nga data e lëshimit të tyre. Dokumentet pranohen në formën e tyre origjinale, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të gjitha dokumentet e lëshuara në Republikën e Shqipërisë, pranohen kur janë nënshkruar nga titullari i institucionit që i lëshon ato. Këto dokumente nuk kanë nevojë për vulë apostile apo legalizim nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme.

8. Në rastet e ndryshimit të gjeneraliteteve për personat që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe kanë fituar një shtetësi të huaj, të paraqitet dokument zyrtar i cili vërteton ndryshimin e gjeneraliteteve në shtetin e shtetësisë së huaj, i legalizuar/apostiluar, përkthyer dhe noterizuar.

9. Dokumentet të cilat gjenerohen nga sistemi *e-albania*, paraqiten të printuara dhe pranohen me vulë digjitale. Në rastet e aplikimit për heqje dorë dhe rifitim të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pranohen të printuara dhe të firmosura nga konsulli në Misionin Diplomatik dhe Postin Konsullor të Republikës së Shqipërisë, të shoqëruara me procesverbalin e dokumenteve që përmban dosja e aplikuesit.

10. Misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë duhet të depozitojnë procesverbalin dhe dosjen e dokumenteve të aplikimit, brenda 1 (një) muaji nga data e dorëzimit



pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, e cila duhet të kalojë praktikën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Ministrinë e Brendshme.

11. Dokumentet e lëshuara nga administrata e shtetit të huaj duhet të jenë të legalizuara/apostiluara sipas regjimit me shtetin përkatës.

a) pranohen direkt dokumentet e përkthyer dhe noterizuara në Republikën e Shqipërisë;

b) kur përkthimi i dokumenteve kryhet në shtetin e huaj, përkthimi vërtetohet në misionin diplomatik apo postin konsullor.

12. Data e lëshimit të tyre të mos kapërcejë gjashtë muajt e fundit, me përjashtim të dokumentit premtimi i shtetësisë dhe vërtetim banimi/qëndrimi, të cilat kanë vlefshmëri 2 vjet. Në rastet kur për dokumentet e ardhura nga jashtë është i pamundur lëshimi i dokumentit origjinal, për shkak të legjislacionit, atëherë pranohen dokumentet e njësuar me akt noterial.

13. Afatet e vlefshmërisë së shqyrtimit të dokumenteve llogariten mbi bazën e datës së pranimit të tyre, nga drejtoria vendore e policisë ose misioni diplomatik apo posti konsullor i Republikës së Shqipërisë i akredituar në shtetin ku ka vendbanimin deri në dekretim (përlllogaritja e afateve të vlefshmërisë së dokumenteve fillon nga data e kryerjes së pagesës nga aplikuesi).

XI. PROCEDURA PËR KRYERJEN E VERIFIKIMEVE PRANË INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE

1. Pas aplikimit për fitim, rifitim dhe heqje dorë nga shtetësia shqiptare nëpërmjet platformës elektronike *online*, struktura vendore e policisë së shtetit, verifikon saktësinë dhe rregullsinë e dokumentacionit të dorëzuar pranë saj.

2. Nëse dokumentacioni është i plotë dhe i saktë, struktura vendore e policisë së shtetit njofton aplikuesin nëpërmjet adresës elektronike mbi pranimin e aplikimit, si dhe i bashkëlidh faturën e arkëtimit mbi tarifën e shërbimit, të cilën pas kryerjes së pagesës në bankë, duhet ta dërgojë nëpërmjet shërbimit postar së bashku me ato dokumente origjinale dhe/ose të noterizuara sipas kërkesave të këtij udhëzimi.

3. Në zbatim të këtij udhëzimi, procedurat e pranimit të kërkesave nga strukturat vendore përgjegjëse të Policisë së Shtetit, si dhe dhëniet e mendimit nga specialistët e policisë kriminale, përcaktohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

4. Për aplikimet për fitim dhe rifitim të shtetësisë shqiptare, struktura përgjegjëse për shtetësinë në Ministrinë e Brendshme, kur evidenton se dokumentacioni është i plotë dhe konform ligjit, vijon me verifikimin e tyre pranë Shërbimit Informativ të Shtetit.

5. Për aplikimet për heqje dorë nga shtetësia shqiptare, struktura përgjegjëse për çështjet e shtetësisë pranë Ministrisë së Brendshme, vijon me verifikimin e tyre, vetëm në rastet kur aplikimet përcillen nga misionet diplomatike apo postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Në këto raste, punonjësi përgjegjës, kur evidenton se dokumentacioni është i plotë dhe konform ligjit, harton shkresën për çdo aplikues dhe e përcjell atë pranë drejtorisë vendore të policisë, sektori i rendit dhe i sigurisë publike.

6. Për heqjen e shtetësisë pa kërkesë, në rastet e përcaktuara në nenin 15, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, pas marrjes së informacionit, struktura përgjegjëse për çështjet e shtetësisë pranë Ministrisë së Brendshme, përgatit shkresën së bashku me materialet përkatëse dhe përcjell për verifikime informacionet e marra në organet ligjzbatuese.

XII. PROCEDURA PËR KRYERJEN E BETIMIT

1. Personi që fiton shtetësinë shqiptare, pas botimit të dekretit të Presidentit në Fletoren Zyrtare, brenda gjashtë muajve, kryen betimin për besnikëri ndaj shtetit shqiptar dhe për respektimin e Kushtetutës e të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, para kryetarit të bashkisë, në territorin e së cilës ka vendbanimin ose para punonjësit të autorizuar prej tij.

2. Betimi për fitimin e shtetësisë shqiptare kryhet nga të gjithë personat, të cilëve u është miratuar fitimi i shtetësisë shqiptare, me përjashtim të atyre personave, të cilët janë në kushte të pamundësisë për t’u paraqitur në zyrën e gjendjes civile në bashki/njësinë për arsye të justifikuara shëndetësore.

3. Me marrjen e njoftimit për fitimin e shtetësisë shqiptare nga Institucioni i Presidentit të Republikës, personat që u është miratuar shtetësia shqiptare paraqesin në zyrën e gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative dokumentacionin e nevojshëm, të lëshuar nga vendi i origjinës, siç janë dokumentet: certifikatë personale, certifikatë familjare dhe certifikatë martese, të përkthyer në gjuhën shqipe, me vulën apostile ose të legalizuara.



4. Pas dërgimit të dekretit për fitim të shtetësisë shqiptare, zyrës respektive të gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative, paracaktohet në shpallje të lirë publike, data dhe ora e betimit, e cila i korrespondon çdo dite të hënë.

5. Njoftimi për datën e kryerjes së betimit dërgohet në adresën e personit, të cilit i është dekretuar fitimi i shtetësisë shqiptare.

6. Në rastet e fitimit të shtetësisë, sipas nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, betimi mund të kryhet edhe pranë misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Shqipërisë të akredituar në shtetin ku personi ka vendbanimin e fundit.

7. Në përfundim të procedurës së betimit, zyra e gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative kryen procedurat e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010 dhe më pas personi që ka kryer betimin, efektivisht shtetas shqiptar, aplikon për pajisje me dokumentin e identifikimit, letërnjoftim dhe pasaportë.

XIII. PROCEDURA DHE DOKUMENTACIONI PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR KRYERJEN E BETIMIT

1. Në rast të moszbatimit të afatit 6-mujor (gjashtëmujor) për kryerjen e betimit në zyrën e gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative, për shkaqe të justifikuara objektive dhe të arsyeshme, personi, i cili e ka të pamundur të paraqitet për të kryer betimin, duhet të paraqesë kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues në Ministrinë e Brendshme për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit, për aq kohë sa parashikohet se mund të zgjasin shkaqet që kanë diktuar shtyrjen e afatit.

2. Në çdo rast, ky afat duhet t'i korrespondojë një periudhe jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 22, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar.

3. Me paraqitjen e këtyre dokumenteve, të cilat shqyrtohen nga struktura për shtetësinë në Ministrinë e Brendshme, lëshohet konfirmimi për pranimin/mospranimin e kërkesës, i cili më pas i përcillet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila e adreson për ndjekje të mëtejshme në zyrën respektive të gjendjes civile në bashkinë / njësinë administrative, për vijimin e procedurës së betimit për fitimin e shtetësisë shqiptare.

XIV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së

Brendshme, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe strukturat vendore të Policisë së Shtetit.

2. Për sa më sipër, në zbatim të udhëzimit të ministrit të Brendshëm nr. 64, datë 4.2.2021, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për dokumentacionin e nevojshëm, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës për heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, për personat që banojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë", kërkohej plotësimi i dokumentacionit dhe ridërgimi i praktikës së plotë pranë Ministrisë së Brendshme, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Udhëzimi i ministrit të Brendshëm nr. 65, datë 4.2.2021, "Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për fitimin, heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës, të procedurës për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse, si dhe të procedurës dhe të dokumentacionit për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani

UDHËZIM Nr. 1020, datë 25.11.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 757, DATË 30.9.2024, "PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT, VLERËSIMIT DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE PËR LICENCIM, TË SUBJEKTEVE QË KRYEJNË VEPRIMTARI TË NDËRMJETËSIMIT NË TREGUN E PUNËS DHE MONITORIMIN E TYRE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar; të nenit 20, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të



ndryshuar dhe të pikës 5, kreu II, të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të planit të veprimeve të “Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 757, datë 30.9.2024, “Për procedurat e shqyrtimit, vlerësimit dhe miratimit të kërkesave për licencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të ndërmjetësimit në tregun e punës dhe monitorimin e tyre”, pika 5, e nenit 3, të kreut II, ndryshon si më poshtë:

“5. Dokument vërtetues për ngurtësimin e një kapitali si rezervë sigurie për të tretët, jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS
DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

URDHËR

Nr. 286, datë 19.11.2024

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE KRITEREVE PËR ZBATIMIN E TESTIT TË EKUILIBRIT EKONOMIK NË TRANSPORTIN HEKURUDHOR TË UDHËTARËVE”²

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 14, të ligjit nr. 142/2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, të nenit 70, të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Mbi përcaktimin e procedurës dhe kritereve për zbatimin e testit të

ekuilibrit ekonomik në transportin hekurudhor të udhëtarëve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Rregullator Hekurudhor, administratorët e infrastrukturës dhe sipërmarrësit hekurudhor për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE

MBI PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE KRITEREVE PËR ZBATIMIN E TESTIT TË EKUILIBRIT EKONOMIK NË TRANSPORTIN HEKURUDHOR TË UDHËTARËVE

Neni 1 Objekti

Kjo rregullore përcakton detajet e procedurës dhe kritereve që duhen ndjekur kur përcaktohet nëse ekuilibri ekonomik i një kontrate shërbimi publik për transportin hekurudhor të udhëtarëve do të rrezikohet nga një shërbim i ri i udhëtarëve hekurudhor.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet për situatat kur është vendosur kufizimi i të drejtës së aksesit të përmendur në nenin 13, pika 1, të ligjit nr. 142/2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, në vijim Kodi, për shërbimet e reja hekurudhore të udhëtarëve ndërmjet një vendi të caktuar nisjeje dhe një destinacioni të caktuar, kur një ose më shumë kontrata të shërbimit publik mbulojnë të njëjtën linjë ose një linjë alternative, siç parashikohet në nenin 14, pika 1 të po këtij ligji.

² Kjo rregullore përaftron plotësisht me:

- Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2018/1795, e datës 20 nëntor 2018, që përcakton procedurën dhe kriteret për aplikimin e testit të ekuilibrit ekonomik, në përputhje me nenin 11

të direktivës 2012/34/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (tekst me rëndësi për EEA), C/2018/7569, OJ L 294, 21.11.2018, f. 5–14.



Neni 3 Përkufizimet

Për qëllim të kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “Shërbim i ri i udhëtarëve hekurudhor” nënkupton një shërbim hekurudhor udhëtarësh i projektuar për t’u operuar si një shërbim i rregullt me orar, që është ose tërësisht i ri, ose që nënkupton një modifikim thelbësor të një shërbimi ekzistues hekurudhor për udhëtarët, veçanërisht në drejtim të rritjes së frekuencave të shërbimeve ose rritjes së numrit të ndalesave, dhe që nuk ofrohet në bazë të kontratës së shërbimit publik;

2. “Testi i ekuilibrit ekonomik” nënkupton procesin e vlerësimit të përshkruar në nenin 14, pika 2 e Kodit dhe i përshkruar më tej në nenin 13, dhe i kryer nga Autoriteti Rregullator Hekurudhor, në vijim ARRH, për të përcaktuar nëse ekuilibri ekonomik i një kontrate shërbimi publik do të rrezikohet nga shërbimi i ri i propozuar i udhëtarëve hekurudhor;

3. “Kontratë shërbimi publik” nënkupton një ose më shumë akte ligjërish të detyrueshme që konfirmojnë marrëveshjen ndërmjet një autoriteti kompetent dhe një operatori të shërbimit publik për t’i besuar atij operatori të shërbimit publik menaxhimin dhe funksionimin e shërbimeve të transportit publik të pasagjerëve që u nënshtrohen detyrimeve të shërbimit publik;

4. “Autoritet kompetent” nënkupton çdo autoritet publik që ka kompetencën ligjore për të ndërhyrë në transportin publik të udhëtarëve në një zonë të caktuar gjeografike ose çdo organ të ngarkuar me këtë autoritet;

5. “Ndikim financiar neto” nënkupton ndikimin e shërbimit të ri hekurudhor të udhëtarëve në bilancin neto të kostove dhe të ardhurave që rrjedhin nga përmbushja e detyrimeve të shërbimit publik të përcaktuara në një kontratë shërbimi publik, i cili përfshin fitim të arsyeshëm;

6. “E drejtë ekskluzive” nënkupton një të drejtë, siç përcaktohet në pikën 18, të nenit 5, të Kodit.

Neni 4 Njoftimi i një shërbimi të ri të planifikuar të udhëtarëve hekurudhor

1. Aplikanti duhet të njoftojë administratorët e infrastrukturës dhe ARRH-në për synimin e tij për
Faqe | 22084

të operuar një shërbim të ri hekurudhor udhëtarësh, për një periudhë jo më pak se 18 muaj para hyrjes në fuqi të afatit me të cilin lidhet kërkesa për kapacitet, në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 39 të Kodit.

2. ARRH publikon në faqen e internetit një formular standard të njoftimit që plotësohet dhe dorëzohet nga aplikanti, i cili kufizohet në informacionin e mëposhtëm:

a) emrin e aplikantit, adresën, personin juridik, numrin e regjistrimit (nëse është e përshtatshme);

b) të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës për pyetjet;

c) të dhënat e licencës dhe certifikatën e sigurisë së aplikantit ose treguesi i fazës së procedurës për marrjen e tyre;

ç) itinerari i detajuar që tregon vendndodhjen e stacioneve të nisjes dhe destinacionit, si dhe të gjitha ndalesat e ndërmjetme;

d) data e planifikuar e fillimit për funksionimin e shërbimit të ri të propozuar të udhëtarëve hekurudhor;

dh) kohën treguese, frekuencën dhe kapacitetin e shërbimit të ri të propozuar të udhëtarëve hekurudhor, duke përfshirë oraret e propozuara të nisjes, oraret e mbërritjes dhe lidhjet, si dhe çdo devijim në frekuencë ose në ndalesa nga orari standard, në çdo drejtim;

e) informacion tregues për mjetet hekurudhore që aplikanti planifikon të përdorë.

3. Informacioni, në lidhje me funksionimin e planifikuar të shërbimit të ri hekurudhor të udhëtarëve, duhet të mbulojë të paktën tre vitet e para dhe, për aq sa është e mundur, pesë vitet e para të funksionimit. Megjithatë, ARRH mund të pranojë për një periudhë më të shkurtër.

4. ARRH publikon në faqen e tij të internetit formularin standard të njoftimit të dorëzuar nga aplikanti dhe njofton sa vijon, pa vonesë të panevojshme dhe më së voni brenda 10 ditëve nga marrja e formularit të plotë të njoftimit:

a) çdo autoritet kompetent që ka dhënë një kontratë shërbimi publik për një shërbim hekurudhor udhëtarësh në atë linjë ose një linjë alternative sipas kuptimit të Kodit;

b) çdo autoritet tjetër kompetent i interesuar me të drejtën për të kufizuar aksesin sipas nenit 17 të Kodit;

c) çdo sipërmarrje hekurudhore që operon shërbime sipas kontratës së shërbimit publik në



itinerarin e shërbimit të ri hekurudhor të udhëtarëve ose një linjë alternative.

5. I gjithë informacioni i dhënë nga aplikanti nëpërmjet formularit standard të njoftimit dhe çdo dokument mbështetës i dërgohet dhe administratorëve të infrastrukturës në formë elektronike. Megjithatë, ARRH, në raste të justifikuara siç duhet, mund të pranojë që dokumentet të dorëzohen në formë letre.

6. Nëse njoftimi është i paplotë, ARRH informon aplikuesin se kërkesat e pakompletuara nuk do të shqyrtohen dhe i jep kërkuarit mundësinë që ta plotësojë kërkesën e tij brenda një kohe të arsyeshme që nuk i kalon dhjetë ditë pune.

Neni 5

Afati i fundit për të kërkuar testin e ekuilibrit ekonomik

1. Çdo kërkesë për një test ekuilibri ekonomik i bëhet ARRH-së nga subjektet e përmendura në pikën 2, neni 14, i Kodit, brenda afatit të përcaktuar në atë dispozitë.

2. Kur, në momentin e marrjes së njoftimit të aplikantit të përmendur në nenin 4, një kontratë shërbimi publik që mbulon të njëjtën linjë ose një linjë alternative po tenderohet në mënyrë konkurruese dhe afati për paraqitjen e ofertave pranë autoritetit kompetent ka skaduar, një test ekuilibri ekonomik mund të kërkohe brenda afatit të përmendur në pikën 2, nenit 14, të Kodit, në lidhje me kontratën e ardhshme të shërbimit publik.

Kjo nuk cenon zbatimin e kësaj rregulloreje për një kontratë shërbimi publik, e cila është në vazhdim e sipër në momentin e njoftimit të aplikantit.

3. Nëse brenda afatit të përmendur në paragrafin 1 nuk bëhet asnjë kërkesë për një test të ekuilibrit ekonomik, ARRH informon pa vonesë aplikantin dhe administratorin e infrastrukturës, i cili e përpunon kërkesën për akses në përputhje me seksionin 3, të kreut 3 të Kodit.

Neni 6

Kontratat e shërbimit publik me të drejta ekskluzive

Kur një autoritet kompetent i ka dhënë të drejta ekskluzive sipërmarrjes hekurudhore që kryen një kontratë shërbimi publik, në përputhje me nenin 151 të Kodit, ekzistenca e këtyre të drejtave nuk

përfshihet aksesin që t'i jepet një aplikanti për qëllimin e operimit të një shërbimi të ri hekurudhor udhëtarësh, me kusht që aksesin të mos rrezikojë ekuilibrin ekonomik të kontratës së shërbimit publik.

Gjatë kryerjes së testit, në përputhje me nenin 10, ARRH merr parasysh vlerën e çdo të drejte ekskluzive të tillë.

Neni 7

Kërkesat e informacionit për testin e ekuilibrit ekonomik

1. Subjekti që kërkon testin e ekuilibrit ekonomik duhet të japë informacionin e mëposhtëm:

a) emrin, adresën, personin juridik, numrin e regjistrimit të subjektit kërkuar (nëse është e nevojshme);

b) informacionin e kontaktit të personit përgjegjës për pyetje;

c) vërtetimi se ekuilibri ekonomik i kontratës rrezikon të rrezikohet nga shërbimi i ri i pasagjerëve hekurudhor;

ç) nëse subjekti kërkuar është autoriteti kompetent ose ndërmarrja hekurudhore që kryen kontratën e shërbimit publik, një kopje të kontratës së shërbimit publik.

2. ARRH mund të kërkojë çdo informacion të nevojshëm, duke përfshirë, sipas rastit:

a) nga autoriteti kompetent:

i. parashikimet përkatëse të trafikut, kërkesës dhe të ardhurave, duke përfshirë metodologjinë e parashikimit;

ii. kur është e përshtatshme, metodologjinë dhe të dhënat e përdorura për llogaritjen e efektit financiar neto në përputhje me nenin 153 të Kodit;

b) nga sipërmarrja hekurudhore që kryen kontratën e shërbimit publik:

i. kopje të kontratës së shërbimit publik, nëse nuk parashikohet në shkronjën “ç”, të pikës 1;

ii. planin e biznesit të sipërmarrjes për itinerarin e mbuluar nga kontrata e shërbimit publik ose një rrugë alternative;

iii. parashikimet përkatëse të trafikut, kërkesës dhe të ardhurave, duke përfshirë metodologjinë e parashikimit;

iv. informacion mbi të ardhurat dhe marzhetet e fitimit të fituara nga sipërmarrja në linjën e mbuluar nga kontrata e shërbimit publik ose një linjë alternative;



v. informacione për orarin e shërbimeve, duke përfshirë oraret e nisjes, ndalesat e ndërmjetme, oraret e mbërritjes dhe lidhjet,

vi. elasticitetet e vlerësuar të shërbimeve (p.sh. elasticiteti i çmimit, elasticiteti në lidhje me karakteristikat cilësore të shërbimeve);

vii. koston e kapitalit dhe kostot operative për shërbimet e ofruara sipas kontratës së shërbimit publik, si dhe ndryshimet në kosto dhe kërkesë të shkaktuara nga shërbimi i ri i udhëtarëve hekurudhor;

c) nga aplikanti, informacion në lidhje me planet e tij për funksionimin e shërbimit të ri të udhëtarëve hekurudhor, duke përfshirë:

i. plan biznesi;

ii. parashikimi i trafikut të udhëtarëve dhe të ardhurave, duke përfshirë metodologjinë e parashikimit;

iii. strategjitë e çmimeve;

iv. aranzhimet e biletave;

v. specifikimet e mjeteve hekurudhore (p.sh.: faktori i ngarkesës, numri i sediljeve, konfigurimi i mjetit);

vi. strategjia e marketingut;

d) nga administratori i infrastrukturës:

i. informacion, në lidhje me linjat ose seksionet përkatëse, në mënyrë që të sigurohet që shërbimi i ri i udhëtarëve hekurudhor mund të kryhet në infrastrukturën përkatëse;

ii. informacion mbi performancën e mundshme dhe ndikimet elastike të shërbimit të ri të propozuar të udhëtarëve hekurudhor;

iii. vlerësimi i ndikimeve në përdorimin e kapaciteteve;

iv. planet për zhvillimin e infrastrukturës për sa i përket linjave të mbuluara nga shërbimi i ri i propozuar i udhëtarëve hekurudhor, duke përfshirë një tregues të kohës kur do të zbatohet ndonjë plan i tillë;

v. informacion mbi marrëveshjet përkatëse kuadër të lidhura ose në diskutim, veçanërisht me sipërmarrjen që kryen kontratën e shërbimit publik.

Detyrimet e informacionit të administratorit të infrastrukturës të përcaktuara më sipër nuk cenojnë detyrimet e tij sipas procedurës së alokimit të përmendur në seksionin 3, të kreut 3 të Kodit.

3. I gjithë informacioni i dërgohet ARRH-së në adresën elektronike të faqes zyrtare, me *email* ose dorëzohen në formë letre.

Neni 8

Konfidencialiteti

1. ARRH nuk duhet të zbulojë informacione të ndjeshme komerciale të marra nga palët, në lidhje me testin e ekuilibrit ekonomik.

2. Subjekti që kërkon testin e ekuilibrit ekonomik dhe aplikanti duhet të sqarojë çdo dokument të propozuar të informacionit tregtar në momentin që informacioni i jepet ARRH-së. Një informacion i tillë mund të përfshijë, në veçanti, informacion teknik ose financiar, në lidhje me njohuritë e një sipërmarrjeje, planin e biznesit, strukturat e kostos, strategjitë e marketingut dhe çmimeve, burimet e furnizimit dhe pjesët e tregut. ARRH redakton çdo informacion të ndjeshëm tregtar nga vendimi i tij përpara njoftimit dhe publikimit të tij, në përputhje me nenin 11, pika 5. Informacioni i përfshirë në formularin standard të njoftimit, siç specifikohet në nenin 4, pika 2, nuk do të konsiderohet komercialisht i ndjeshëm.

3. Nëse ARRH konstaton se arsyet e sqarimit të parashikuara në pikën 2 nuk mund të pranohen, ai vendim i komunikohet dhe arsyetohet me shkrim palës që kërkon konfidencialitet, jo më vonë se dy javë para miratimit të vendimit të përmendur në neni 11, pika 1.

4. Vendimi i ARRH-së për konfidencialitetin i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor, sipas shkronjës “c”, pika 10, neni 56 i Kodit. Organi rregullator nuk do të zbulojë informacionin e kontestuar derisa gjykata të ketë nxjerrë një vendim mbi konfidencialitetin.

Neni 9

Procedura për testin e ekuilibrit ekonomik

1. ARRH i kërkon subjektit që kërkon testin e ekuilibrit ekonomik çdo informacion shtesë që e gjykon të nevojshëm, në përputhje me nenin 7, pika 2, brenda një muaji nga marrja e kërkesës. Subjekti kërkuar e jep këtë informacion brenda një afati të arsyeshëm të caktuar nga ARRH, i cili kërkon informacione të mëtejshme nëse konsideron se informacioni shtesë i marrë nuk është i mjaftueshëm.

2. Në rast se gjashtë javë përpara datës përfundimtare për marrjen e kërkesave për kapacitet informacioni i dhënë nga subjekti kërkuar është ende i paplotë, ARRH kryen testin në bazë të



informacionit të disponueshëm. Megjithatë, nëse ARRHH konsideron se informacioni është i pamjaftueshëm për të kryer testin, ai e refuzon kërkesën.

3. Brenda një muaji nga marrja e kërkesës për testin e ekuilibrit ekonomik, ARRHH u kërkon, gjithashtu, palëve të tjera të përmendura në nenin 7, pika 2, informacionin e nevojshëm për të kryer testin, në përputhje me këtë dispozitë, në masën që një informacion i tillë mund të ofrohet në mënyrë të arsyeshme nga pala e interesuar. Kur informacioni i dhënë në këtë mënyrë është i paplotë, ARRHH kërkon sqarime të mëtejshme, duke vendosur afate të arsyeshme.

4. Në rast se gjashtë javë përpara datës përfundimtare për marrjen e kërkesave për kapacitet informacioni i dhënë nga aplikanti që kërkon akses është ende i paplotë, ARRHH kryen testin në bazë të informacionit të disponueshëm. Megjithatë, nëse ARRHH konsideron se informacioni i dhënë nga aplikanti është i pamjaftueshëm për të kryer testin, ai e refuzon aksesin.

5. Kur sipërmarrja që kryen kontratën e shërbimit publik nuk është subjekti kërkuar, dhe kur gjashtë javë përpara datës përfundimtare për marrjen e kërkesave për kapacitet, informacioni i dhënë nga kjo sipërmarrje është ende e paplotë, ARRHH kryen testin në bazë të informacionit të disponueshëm. Megjithatë, nëse ARRHH konsideron se informacioni i dhënë është i pamjaftueshëm për të kryer testin, ai lejon aksesin.

6. ARRHH miraton një vendim brenda gjashtë javësh nga marrja e të gjithë informacionit përkatës, dhe në çdo rast përpara datës përfundimtare për marrjen e kërkesave për kapacitet. Organi rregullator të informojë administratorin e infrastrukturës për vendimin e tij pa vonesë.

7. Kur një kërkesë për testin e ekuilibrit ekonomik bëhet sipas nenit 5, pika 2, në lidhje me një kontratë shërbimi publik, e cila është në proces të tenderimit në mënyrë konkurruese, ARRHH pezullon shqyrtimin e aplikimit të propozuar për një shërbim të ri hekurudhor të udhëtarëve për një periudhë maksimale prej 12 muajsh nga marrja e njoftimit të aplikantit për shërbimin e ri hekurudhor të udhëtarëve ose deri në përfundimin e procesit të tenderit, cilado qoftë më shpejt.

Neni 10

Përmbajtja e testit të ekuilibrit ekonomik dhe kriteret e vlerësimit

1. ARRHH vlerëson nëse ekuilibri ekonomik i një kontrate shërbimi publik rrezikohet nga shërbimi i ri i propozuar i udhëtarëve hekurudhor. Ekuilibri ekonomik konsiderohet i rrezikuar kur shërbimi i ri hekurudhor i udhëtarëve ka një ndikim të konsiderueshëm negativ në të paktën një nga elementet e mëposhtme:

a) përfitimin e shërbimeve që sipërmarrja hekurudhore operon sipas kontratës së shërbimit publik;

b) koston neto për autoritetin kompetent që jep kontratën e shërbimit publik.

2. Analiza i referohet kontratës së shërbimit publik në tërësi dhe jo shërbimeve individuale të operuara sipas saj, gjatë të gjithë kohëzgjatjes së saj. Mund të zbatohen pragje të paracaktuara ose kriteret specifike, por jo në mënyrë rigoroze ose të izoluar nga kriteret e tjera.

3. ARRHH vlerëson ndikimin financiar neto të shërbimit të ri hekurudhor të udhëtarëve në kontratën e shërbimit publik. Analiza e kostove dhe të ardhurave të krijuara në funksionimin e shërbimeve të mbuluara nga kontrata e shërbimit publik pas hyrjes në treg të shërbimit të ri të udhëtarëve hekurudhor përfshin elementet e mëposhtme:

a) ndryshimi në kostot e bëra dhe të ardhurat e marra nga sipërmarrja hekurudhore që kryen kontratën e shërbimit publik (duke përfshirë aty ku është e nevojshme çdo kursim në kosto, të tilla si ato që rrjedhin nga moszëvendësimi i mjeteve hekurudhore që kanë mbushur orët e punës të dobishme ose personelit të cilit i përfundon kontrata);

b) efektet financiare të gjeneruara brenda rrjetit sipas kontratës së shërbimit publik nga shërbimi i ri i propozuar i udhëtarëve hekurudhorë (siç është sjellja e udhëtarëve që mund të jenë të interesuar për një lidhje me një shërbim rajonal të mbuluar nga kontrata e shërbimit publik);

c) përgjigjet e mundshme konkurruese nga sipërmarrja hekurudhore që kryen kontratën e shërbimit publik;

d) ndikimi në investimet përkatëse nga sipërmarrjet hekurudhore ose nga autoritetet kompetente, për shembull në mjetet lëvizëse;



e) vlerën e çdo të drejte ekskluzive ekzistuese.

4. ARRH vlerëson rëndësinë e ndikimit duke marrë parasysh, në veçanti, marrëveshjet kontraktuale të vendosura ndërmjet autoritetit kompetent dhe sipërmarrjes hekurudhore që operon shërbimet publike, duke përfshirë kur është e aplikueshme nivelin e kompensimit ose që rezultojnë nga çmimi konkurrues dhe çdo mekanizëm për ndarjen e rreziqeve, të tilla si rreziqet e trafikut dhe të ardhurave.

5. ARRH vlerëson, gjithashtu:

a) përfitimet neto për klientët që rrjedhin nga shërbimi i ri i udhëtarëve hekurudhor në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme;

b) ndikimi i shërbimit të ri hekurudhor të udhëtarëve në performancën dhe cilësinë e shërbimeve hekurudhore;

c) ndikimi i shërbimit të ri hekurudhor të udhëtarëve në planifikimin e orarit për shërbimet hekurudhore.

6. Kur ARRH shqyrton më shumë se një aplikim për akses, ai merr vendime të ndryshme për aplikimet e marra, bazuar në një analizë të ndikimeve të tyre përkatëse në ekuilibrin ekonomik të kontratës së shërbimit publik, efektet konkurruese, përfitimet neto për klientët dhe ndikimet e rrjetit, dhe efektet e tyre kumulative në ekuilibrin ekonomik të kontratës së shërbimit publik.

7. Vlerësimi i kryer në përputhje me këtë nen nuk cenon detyrimin e ARRH-së për të raportuar çështjet e ndihmës shtetërore tek autoritetet kombëtare, në përputhje me shkronjën “e”, pika 10, të nenit 56 të Kodit.

Neni 11

Rezultati i testit të ekuilibrit ekonomik

1. Si rezultat i testit të ekuilibrit ekonomik të kryer në përputhje me nenet 9 dhe 10, organi rregullator merr një vendim të parashikuar në pikën 2, neni 14 i Kodit, në bazë të të cilit e drejta e aksesit në infrastrukturën hekurudhore jepet, modifikohet, jepet vetëm me kushte ose refuzohet.

2. Kur ekuilibri ekonomik i një kontrate shërbimi publik rrezikohet nga shërbimi i ri i udhëtarëve hekurudhor, ARRH:

a) tregon, sipas rastit, ndryshimet e mundshme në atë shërbim të ri hekurudhor për udhëtarët, të tilla si një modifikim i frekuencave, linjave, ndalesave të ndërmjetme ose orareve, të cilat do siguronin që

kushtet për dhënien e të drejtës së aksesit të parashikuara në pikën 2, neni 13 i Kodit, janë përmbushur; dhe/ose

b) lëshon rekomandime për autoritetet kompetente, kur është e nevojshme, duke konsideruar përfitimet neto për klientët e përmendur në pikën “a”, të nenit 10, pika 5 të kësaj rregulloreje, në lidhje me ndryshime të tjera që nuk lidhen me shërbimin e ri të udhëtarëve që sigurojnë plotësimin e kushteve për dhënien e së drejtës së aksesit.

3. Kur kërkesa për akses ka të bëjë me funksionimin e një shërbimi të ri për trena me shpejtësi të lartë, ARRH vepron duke ndjekur procedurën dhe analizën e përcaktuar në këtë rregullore.

4. Në rrethanat e përshkruara në nenin 5, pika 2, nënparagrafi i dytë, kur testi i ekuilibrit ekonomik në kontratën ekzistuese të shërbimit publik tregon se akses mund të jepet, ai do të jetë i kufizuar në kohë, në pritje të rezultatit të testit të ekuilibrit ekonomik dhe kryhet në përputhje me nenin 5, 2, paragrafi i parë dhe nenin 9, pika 7.

5. ARRH njofton një version jokonfidencial të vendimit të tij subjekteve të listuara në pikën 2, neni 14 i Kodit, dhe e publikon atë në faqen e tij të internetit.

Neni 12

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve rregullatore kompetente për një shërbim të ri ndërkombëtar të udhëtarëve

1. Pas marrjes së njoftimit të aplikantit për synimin e tij për të filluar një shërbim të ri ndërkombëtar udhëtarësh, ARRH informon homologët e vendeve të tjera që kanë kompetencë për itinerarin e shërbimit të ri të propozuar. Organet rregullatore në fjalë kontrollojnë informacionin e marrë dhe informojnë njëri-tjetrin për çdo mospërputhje.

2. Me marrjen e një kërkesë nga subjektet e referuara në nenin 14 të Kodit, për një test të ekuilibrit ekonomik, ARRH informon për këtë homologët e tjera kompetente.

3. ARRH i jep homologëve rezultatet e testeve të tyre përkatëse të ekuilibrit ekonomik, në mënyrë që të krijojnë mundësi të mjaftueshme për të komentuar rezultatet e këtyre testeve përpara se ato të finalizohen. Ata bashkëpunojnë për të sjellë një



zgjidhje të çështjes në përputhje me nenin 57 të Kodit.

4. Gjatë çdo shkëmbimi informacioni në lidhje me testet, organet rregullatore respektojnë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm komercial të marrë nga palët e përfshira në teste. Ata mund të përdorin informacionin vetëm për rastin në fjalë.

Neni 13

Tarifat

ARRH vendos një tarifë në zbatim të ligjit nr. 89/2021, “Për krijimin e Autoritetit Rregullator Hekurudhor”, për testin e ekuilibrit ekonomik nga subjekti që kërkon testin dhe e publikon në faqen e vet zyrtare.

Neni 14

Metodologjia

1. Metodologjia e përdorur nga ARRH për kryerjen e testit duhet të jetë e qartë, transparente dhe jodiskriminuese dhe publikohet në faqen e tij të internetit.

2. ARRH shkëmben përvojat dhe praktikat më të mira me homologët në zbatimin e metodologjive përkatëse në kontekstin e rrjetit të vendosur në nenin 57 të Kodit.

URDHËR

Nr. 1018, datë 25.11.2024

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Sekretarit të Përgjithshëm z. Albin Gega, drejtor i përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Punësimit, Aftësimit dhe Sigurimeve në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

2. Kompetencat e deleguara të Sekretarit të Përgjithshëm do të ushtrohen nga data 26.11.2024 deri më 3.12.2024.

3. Ngarkohet z. Albin Gega për zbatimin e këtij urdhri, Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri, si dhe të gjithë punonjësit për zbatim.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS
DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

URDHËR

Nr. 2163, datë 21.11.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të gremës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; gremës “c”, e pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave z. Ardit Kasemi, drejtor i Drejtorisë së Kadastrës dhe Monitorimit të Titujve të Pronësisë për sa vijon:

- Për të trajtuar dhe nënshkruar shkresat, me karakter njohës dhe informues, dalëse të Drejtorisë së Përgjithshme, pjesë e fushës së përgjegjësisë të Drejtorisë së Kadastrës dhe Monitorimit të Titujve të Pronësisë, që u drejtohen të tretëve (personave fizikë, personave juridikë, publikë apo privatë), si dhe ato drejtuar strukturave të varësisë të ASHK-së në funksion të informimit të të tretëve.

Sa më sipër, bëjnë përjashtim shkresat që i drejtohen Presidentit të Republikës, Kuvendit, Kryeministrit, ministrave, sekretarit të përgjithshëm të Kryeministrit/ministrave, Avokatit të Popullit, prefektit, si dhe kryetarëve të bashkive, të cilat janë kompetencë e drejtorit të përgjithshëm dhe nënshkruhen prej tij.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, drejtori i Drejtorisë së Kadastrës dhe



Monitorimit të Titujve të Pronësisë, nëse e vlerëson të nevojshme, mund t'i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm shkresat të cilat përbëjnë një rëndësi të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

4. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Drejtorisë së Kadastrës dhe Monitorimit të Titujve të Pronësisë, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, e Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohet duke filluar nga data e miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Ngarkohet Drejtoria e Kadastrës dhe Monitorimit të Titujve të Pronësisë dhe drejtori i tyre, z. Ardit Kasemi, dhe Drejtoria e Investimeve dhe Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli

URDHËR
Nr. 2164, datë 21.11.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të germës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; germa “c”, e pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave znj. Jonida Brati, drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor për sa vijon:

Faqe | 22090

- Për të trajtuar dhe nënshkruar shkresat, me karakter njohës dhe informues, dalëse të Drejtorisë së Përgjithshme, pjesë e fushës së përgjegjësisë të Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor, që u drejtohen të tretëve (personave fizikë, personave juridikë, publikë apo privatë), si dhe ato drejtuar strukturave të varësisë të ASHK-së në funksion të informimit të të tretëve.

Sa më sipër, bëjnë përjashtim shkresat që i drejtohen Presidentit të Republikës, Kuvendit, Kryeministrit, ministrave, sekretarit të përgjithshëm të Kryeministritë/ministrive, Avokatit të Popullit, gjykatave, prokurorive, prefektit, si dhe kryetarëve të bashkive, të cilat janë kompetencë e drejtorit të përgjithshëm dhe nënshkruhen prej tij.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor, nëse e vlerëson të nevojshme, mund t'i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm shkresat të cilat përbëjnë një rëndësi të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”. Shkresat që trajtojnë problematika, mosmarrëveshje administrative apo civile që kërkojnë nxjerrjen e akteve administrative / kryerjen e veprimeve administrative nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm.

4. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit Tekniko-Ligjor, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, e Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohet duke filluar nga data e miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit Tekniko-Ligjor dhe drejtori i tyre, znj. Jonida Brati, dhe Drejtoria e Shërbimeve dhe Investimeve në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 240 lekë

